

Hyundai Auto Albania sh.p.k
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

PËRMBAJTJA:

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	7 – 21

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Drejtimin dhe Ortakëve të Shoqërisë Hyundai Auto Albania sh.p.k

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë **Hyundai Auto Albania sh.p.k** (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2016, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2016, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara në Shqipëri.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likujdijë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

30 qershor 2017



Diana Ylli (Golemi)
Auditues Ligjor



Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2016

	Shënime	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	14,925,067	2,757,839
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	19,296,037	45,949,243
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	-	20,302,397
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	32,520,104	17,068,035
Parapagime për furnizime	8	309,609,792	193,793,639
Inventarë	9	179,669,878	75,871,363
Total aktive afatshkurtra		556,020,878	355,742,516
Aktivet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	10	82,713,762	37,957,054
Total aktive afatgjata		82,713,762	37,957,054
Total aktive		638,734,640	393,699,570
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	11	214,406,487	146,112,367
Llogari të pagueshme tregtare	12	117,347,697	128,431,798
Detyrime tatimore	13	4,330,198	3,135,150
Të ardhurat e shtyra	14	3,718,825	7,222,619
Të tjera detyrime	15	16,345,075	5,760,660
Total detyrime afatshkurtra		356,148,282	290,662,594
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	11	156,287,921	37,795,533
Total detyrime afatgjata		156,287,921	37,795,533
Totali i detyrimeve		512,436,203	328,458,127
KAPITALI			
Kapitali i nënshkruar		100,000	100,000
Rezerva të tjera		5,159,318	2,709,186
Fitime të mbartura		59,982,125	13,429,587
Fitimi i ushtrimit		61,056,994	49,002,670
Total kapitali	16	126,298,437	65,241,443
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		638,734,640	393,699,570

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	17	2,185,966,229	1,288,842,534
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	18	3,023,565	690,239
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shërbime		(2,073,272,399)	(1,202,314,115)
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shpenzime të tjera	19	(2,039,644,610)	(1,165,546,411)
Të tjera shpenzime	20	(33,627,789)	(36,767,704)
Shpenzime te personelit	21	(15,924,585)	(10,643,032)
1) Paga dhe shpërblime		(13,828,960)	(9,286,600)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(2,095,625)	(1,356,432)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	10	(9,193,439)	(2,563,434)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	22	(178,642)	(564,400)
Shpenzime financiare	23	(15,158,401)	(11,144,752)
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		(15,158,401)	(11,592,916)
2) Shpenzime të tjera financiare		-	448,164
Fitimi/humbja para tatimit		75,262,328	62,303,040
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(14,205,334)	(13,300,370)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	24	(14,205,334)	(13,300,370)
2) Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		-	-
Fitimi/humbja e vitit		61,056,994	49,002,670
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		61,056,994	49,002,670

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Hyundai Auto Albania sh.p.k

*(Vlerat janë në Lek)*Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni më 1 janar 2015	100,000	1,360,009	(12,204,777)	26,983,541	16,238,773
Transferim në fitime të mbartura			25,634,364	(25,634,364)	-
Totali i të ardhura gjithpërfshirëse për vitin:				49,002,670	49,002,670
Emetimi i kapitalit të nënshkruar		1,349,177		(1,349,177)	-
Pozicioni më 31 dhjetor 2015	100,000	2,709,186	13,429,587	49,002,670	65,241,443
Transferim në fitime të mbartura			59,982,125	(59,982,125)	-
Totali i të ardhura gjithpërfshirëse për vitin:				61,056,994	61,056,994
Transferim ne rezerva ligjore		2,450,132		(2,450,132)	-
Pozicioni më 31 dhjetor 2016	100,000	5,159,318	73,411,712	47,627,407	126,298,437

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 janë aprovuar nga administratori i Hyundai Auto Albania sh.p.k më _____ dhe janë firmosur si më poshtë:

Ilir Zeka
AdministratorTeuta Jorgo
Financiere

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	75,262,328	62,303,040
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	-	(774,870)
Shpenzime për tatimin mbi fitimin jomonetar	(14,205,334)	(13,300,370)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	9,193,439	2,563,434
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	(729,521)	-
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(84,312,619)	(112,068,983)
Rënie/(rritje) në inventarë	(103,798,516)	134,964,513
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(2,808,432)	(95,816,331)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(121,398,655)	(22,129,567)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(75,108,772)	(30,076,347)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	21,888,147	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(53,220,625)	(30,076,347)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Hua të arkëtuara	186,786,508	7,957,117
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	186,786,508	7,957,117
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	12,167,228	(44,248,797)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	2,757,839	45,783,602
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare	-	1,223,034
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4 14,925,067	2,757,839

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

(Vlerat janë në Lek)

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria Hyundai Auto Albania Shpk është krijuar në vitin 2006, me vendim gjykate Nr. 36760, datë 04.12.2006.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për Shoqëritë tregtare" dhe nga statuti i saj.

Shoqëria Hyundai Auto Albania Shpk është shoqëri shqiptare. Ortak i vetëm është z. Ilir Zeka që zotëron 100% të kuotave të kapitalit të Shoqërisë.

Kapitali i Shoqërisë është 100.000 lekë. Administrator i Shoqërisë nga data 19.07.2011 deri më 19.07.2019 është emëruar z. Ilir Zeka.

Selia e Shoqërisë ndodhet tek Autostrada Tiranë-Durrës, Kilometri 1, Godinë 4 kate, Kashar, Tiranë. Shoqëria është regjistruar me NIPT K62420006T.

Aktiviteti kryesor i kësaj Shoqërie është import automjeteve, shërbim riparimi të tyre, servis universal. Në 31 dhjetor 2016 Shoqëria ka 15 punonjës (2015: 13).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr. 9228, datë 29 prill 2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

Në bazë të urdhrin nr. 64 datë 22.7.2014 "Për Shpalljen e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e Financave vendosi të bëjë të detyrueshëm zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, duke filluar nga 1 janar 2015. Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i Shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme, të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve, janë përshkruar më poshtë:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara, të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në ç'regjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste Shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr. 1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme. Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare, siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale, me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit, ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit të monedhave të huaja më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2016	2015
EUR/LEK	135.23	137.28
USD/LEK	128.17	125.79

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare, instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare ç'regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare ç'regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë, të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar, duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes, duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Kapitali themeletar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë, të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitet financiar të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitet financiar të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve, në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivitet afatgjata materiale paraqiten me kosto, duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitet në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e ç'montimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitet. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitet kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivitet afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundur që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material, duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2016 dhe 2015 është si më poshtë:

Kategoria e AQT-ve	Norma e Amortiz në % 2016	2015	Metoda e llogaritjes
Toka	0	0	
Ndërtime e instalime	5	5	
Makineri e Pajisje	20	20	
Mjete transporti	20	20	Mbi vlerën e mbetur të AAM-ve
Pajisje zyre	20	20	
Pajisje kompiuterike	25	25	
Instrumenta dhe vegla pune	20	20	

iv. Ç'regjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale ç'regjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritjeje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjata të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit, përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2016 është 15% (2015: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimin e pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme, që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës, sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.13. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare, por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Depozita në Bankë e llogari të tjera	13,846,693	759,717
Depozita garancie në Bankë	840,090	1,727,013
Vlera në arkë	238,284	271,109
	<u>14,925,067</u>	<u>2,757,839</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Klientë për mallra, produkte e shërbime	19,296,037	45,949,243
	<u>19,296,037</u>	<u>45,949,243</u>

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë të arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Të drejta ndaj ortakut i shoqërisë	-	20,302,397
	<u>-</u>	<u>20,302,397</u>

(Vlerat janë në Lek)

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Detyrime palë të lidhura	19,910,087	7,022,308
Shteti Tatime dhe Taksa - Tatim Fitimi	9,936,628	-
Shteti Tatime dhe Taksa - Tatim në Burim	95,372	95,372
Paradhënie për punonjësit	1,811,433	248,772
Te tjera kërkesa	522,664	-
Llogari në pritje	243,920	9,701,583
	<u>32,520,104</u>	<u>17,068,035</u>

8. Parapagime për furnizime

Parapagime për furnizime detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Parapagime për blerje Makinash	309,609,792	191,868,223
Parapagime për furnizime	-	1,925,416
	<u>309,609,792</u>	<u>193,793,639</u>

9. Inventari

Inventari më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqitet si me poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Inventar i imët	1,389,434	1,384,400
Mallra Grupi I	178,280,444	74,486,963
	<u>179,669,878</u>	<u>75,871,363</u>

10. Aktive afatgjata materiale

	Ndërtesa	Makineri dhe pajisje	Mjete transporti	Të tjera	Totali
Kosto					
Gjendja më 1 janar 2015	5,130,820	4,657,596	2,407,010	6,774,478	18,969,904
Shtesa	-	156,440	29,892,907	27,000	30,076,347
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2015	5,130,820	4,814,036	32,299,917	6,801,478	49,046,251
Shtesa	-	322,829	71,359,227	3,426,716	75,108,772
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	(23,401,545)	-	(23,401,545)
Gjendja më 31 dhjetor 2016	5,130,820	5,136,865	80,257,600	10,228,194	100,753,478
Amortizim i akumuluar					
Gjendja më 1 janar 2015	500,255	2,567,156	1,072,376	4,385,976	8,525,763
Amortizimi i vitit	231,528	426,700	1,305,780	599,426	2,563,434
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2015	731,783	2,993,856	2,378,156	4,985,402	11,089,197
Amortizimi i vitit	219,952	363,241	8,180,901	429,345	9,193,439
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	(2,242,919)	-	(2,242,919)
Gjendja më 31 dhjetor 2016	951,735	3,357,097	8,316,138	5,414,747	20,282,636
<i>Vlera neto kontabël</i>					
Gjendja më 31 dhjetor 2015	4,399,037	1,820,180	29,921,761	1,816,076	37,957,056
Gjendja më 31 dhjetor 2016	4,179,085	1,779,768	71,941,462	4,813,447	82,713,762

Hyundai Auto Albania sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2016
(Vlerat janë në Lek)

11. Huatë

Huatë më 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

Huadhënësi	Lloji Huase	Data e marrjes	Data e Shlyerjes	Afati	Moneda	Shuma e principal		Balanca e Mbetur		Shuma për t'u shlyer deri	
						EUR	EUR	EUR	ALL	në 1 vit	mbi 1 vit
Nga Bankat											
Intesa San Paolo	OVD	27.02.2015	28.02.2016	1Vit	EUR	300,000	300,871	40,686,826	40,686,826	-	-
Raiffeisen Leasing	Leasing	12.10.2015	11.05.2019	42muaj	EUR	211,477	6,361	860,205	365,662	494,543	
Raiffeisen Leasing	Financim stoku	24.10.2016	21.04.2020	42muaj	EUR	287,082	28,704	3,881,646	906,041	2,975,605	
Raiffeisen Leasing	Financim stoku	17.11.2016	21.04.2020	42muaj	EUR	120,760	35,978	4,865,272	1,127,413	3,737,860	
Raiffeisen Leasing	Financim stoku	16.12.2016	21.05.2020	42muaj	EUR	92,140	72,720	9,833,922	1,865,227	7,968,694	
							143,763	19,441,045	4,264,343	15,176,702	
NBG	OVD	04.12.2016	03.12.2017	1Vit	EUR	250,000	249,659	33,761,324	33,761,324	-	-
							249,659	33,761,324	33,761,324		
Societe Generale	Kredi	21.10.2015	20.10.2020	5vjet	EUR	49,500	31,463	4,254,763	964,485	3,290,278	
Societe Generale	Leasing	29.06.2015	29.06.2018	3Vjet	EUR	124,189	83,908	11,346,811	4,227,290	7,119,521	
Societe Generale	OVD			1Vit	EUR	100,000	85,973	11,626,260	11,626,260	-	-
							201,343	27,227,834	16,818,034	10,409,800	
Banka Credins	Leasing	10.10.2016	10.10.2019	3Vjet	EUR	266,400	199,667	27,000,902	9,467,452	17,533,450	
Banka Credins	Financimstoku	24.10.2016	10.10.2019	3Vjet	EUR	52,320	39,214	5,302,879	1,699,841	3,603,038	
Banka Credins	Financimstoku	22.12.2016	10.12.2019	3Vjet	EUR	173,485	104,697	14,158,137	4,122,487	10,035,651	
							343,577	46,461,919	15,289,780	31,172,139	
Hua nga BKT me Classic shpk	Kredi	16.12.2016	16.12.2019	3Vjet	EUR	600,000	600,000	81,138,000	27,046,000	54,092,000	
							600,000	81,138,000	27,046,000	54,092,000	
Classic S & J	Kredi	11.03.2016	11.03.2017	1Vit	EUR	686,000	336,000	45,437,280	-	45,437,280	
							336,000	45,437,280	-	45,437,280	
Tirana Factoring & Lease	Financim stoku	27.07.2016	27.07.2017	1Vit	EUR	250,000	250,000	33,807,500	33,807,500	-	-
							250,000	33,807,500	33,807,500	-	-
Indrit Bardho	Kredi	23.12.2016	23.12.2017	1Vit	EUR	316,000	316,000	42,732,680	42,732,680	-	-
							316,000	42,732,680	42,732,680	-	-
							2,741,213	370,694,408	214,406,487	156,287,921	

Hyundai Auto Albania sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në Lek)

12. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Furnitorë për mallra, produkte e shërbime	117,347,697	128,413,501
Furnitorë për faturuara të pa mbërritura	-	18,297
	<u>117,347,697</u>	<u>128,431,798</u>

13. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Sigurimet Shoqërore	303,219	187,711
Tatim fitimi	-	2,881,759
TVSH për tu paguar	3,907,711	-
Tatim mbi të Ardhurat Personale të Punonjësve	102,318	56,275
Detyrime doganore	16,950	9,405
	<u>4,330,198</u>	<u>3,135,150</u>

14. Të ardhurat e shtyra

Të ardhurat e shtyra për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015, paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Parapagime të marra për blerje makinash	3,718,825	7,222,619
	<u>3,718,825</u>	<u>7,222,619</u>

15. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Zyra e Shërbimit Përmbartimor (Autoriteti i Konkurrencës)	5,150,660	-
Të tjera Detyrime Ortaku	11,194,415	5,170,660
Të tjera detyrime	-	590,000
	<u>16,345,075</u>	<u>5,760,660</u>

16. Kapitali

Kapitali i shoqërisë është 100,000 LEK, i zotëruar 100% nga ortaku i vetëm Ilir Zeka. Kapitali më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2016			31 dhjetor 2015		
	Kuotat	Vlera nominale	%	Kuotat	Vlera nominale	%
Ilir Zeka	100	1000	100%	100	1000	100%
	<u>100</u>	<u>1000</u>	<u>100%</u>	<u>100</u>	<u>1000</u>	<u>100%</u>

Shoqëria ka fitim më 31 dhjetor 2016 në vlerën 61,056,994 LEK (2015: 49,002,670 LEK).

(Vlerat janë në Lek)

17. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Nga shitje automjetesh	2,117,287,875	1,255,756,133
Kryerja e shërbimeve (servis automjetesh)	5,889,393	3,775,327
Nga shitja e pjesë këmbimi për automjete	50,800,399	28,367,917
Dhënie automjetesh me qera	11,988,562	943,157
	2,185,966,229	1,288,842,534

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së:

	31 dhjetor 2016
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	
Qarkullim i tatueshëm	2,205,982,742
Shtohen të ardhurat e rimarra nga 2015	7,222,619
Zbriten të ardhura të shtyra për 2016	(3,718,825)
Zbriten të ardhurat nga shitja e aktiveve paraqitur neto	(21,158,626)
Të ardhura nga rivlerësimi	661,884
Shuma e qarkullimit e korrektuar	2,188,989,794
Sipas Kontabilitetit	2,188,989,794
Diferenca	-

18. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe rezultatit nga shitja e AAM-ve, të cilat për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Te Ardhura nga Shitja e AAM	21,888,147	-
Vlera e mbetur e AAM te shitura	(21,158,626)	-
Diferencat Pozitive nga Këmbimi	1,873,010	774,871
Diferencat Negative nga Këmbimi	-	(145,851)
Fitim nga këmbimet valutore	421,034	61,219
	3,023,565	690,239

Hyundai Auto Albania sh.p.k
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
 (Vlerat janë në Lek)

19. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndeve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Blerje mallra/pjesë këmbimi	1,979,693,843	1,121,404,043
Qera ndërtese e automjete	11,075,292	10,987,833
Taksë doganore dhe skanimi	3,751,982	1,227,756
Transport në blerje për pjesë dhe makina	33,127,249	18,864,564
Transport në shitje për makina	-	504,216
Shpenzime për karburant	237,571	342,701
Shpenzime për agjensi doganore	2,430,579	1,363,845
Shpenzime riparimi e regjistrimi automjetesh	2,106,422	1,263,080
Shpenzime për marrje makina me qera	256,841	24,500
Regjistrim automjetesh	1,109,976	5,945,160
Update i kontrollit dhe servis makina	797,490	1,833
Sigurim mjetesh dhe TPL	5,057,365	3,616,880
	2,039,644,610	1,165,546,411

20. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Taksa e tarifa vendore	401,000	20,120
Telefoni, internet e DHL	292,462	775,417
Komisione bankare	4,625,324	2,233,092
Shpenzime udhëtim e dieta	1,528,380	872,920
Shpenzime për kontrata me bankat	-	1,216,967
Shpenzime për roje private	3,166,710	1,845,496
Personel nga jashtë, konsulencë e honorare	320,000	300,000
Shpenzime për enegji	1,166,144	770,369
Shpenzime përfaqësimi e pritje përcjellje, reklama	1,659,266	86,168
Shpenzime noterizimi, përmbarimi, gjyqësore e siguracione	1,164,839	2,735,097
Shpenzime per kancelari e dokumenta	301,705	221,301
Shpenzime për mirëmbajtje ambjenti, trajtim punonjësve	349,300	197,350
Shpenzime të ndryshme	2,031,883	342,207
Shpenzime të tjera pa dokumenta të rregullta	9,117,178	24,103,525
Shpenzime për mbyllje parakohe të kontratës shitje makine	182,296	352,061
Sigurim garancie malli	119,248	-
Shpenzime pa fatura	7,202,054	695,614
	33,627,789	36,767,704

21. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Shpenzime për paga	13,828,960	9,286,600
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	2,095,625	1,356,432
	15,924,585	10,643,032

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2016 është 15 (2015: 13).

22. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzime të tjera detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Gjoha dhe dëmshpërblime	178,642	564,400
	178,642	564,400

23. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërise. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Shpenzime për interesa	(15,161,387)	(11,675,177)
Të ardhura nga interesat	2,986	82,261
Fitim nga rivlerësimi I huave	-	448,164
	(15,158,401)	(11,144,752)

24. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
<i>Fitimi para tatimit</i>	75,262,328	62,303,040
<i>Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)</i>		
Gjoha dhe penalitete	178,642	564,400
Shpenzime me fatura jo të rregullta tatimore	7,265,039	933,121
Shpenzim për regjistrim mjete pa faturë	848,892	765,049
Shpenzime për mbyllje parakohore të kontr. Shitjes makinës	186,054	-
Shpenzime të tjera pa dokumenta të rregullta	9,117,178	24,103,525
Shpenzime për interesa të panjohura	1,184,207	-
Shpenzime të tjera	659,885	-
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	<u>94,702,225</u>	<u>88,669,135</u>
<i>Tatim fitimi @15%</i>	14,205,334	13,300,370
	<u><u>61,056,994</u></u>	<u><u>49,002,670</u></u>

25. Angazhime dhe pasiguri

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

26. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

Mazars

Address

Rruga Emin Duraku, Pall. "Binjaket", Nr.5
Tirane, Shqiperi
Tel. +355 (0) 42 278 015
audit@mazars.al

www.mazars.al